



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 3032/prot
2

Gramsh, më 10.08/2026

V E N D I M

Nr. 59 _datë, 31/07 / 2026

P Ë R

KALIMIN NË FOND BANESE TË OBJEKTIT "ISH NDËRMARRJA E SHQOPAVE"
PASURIA NR. 7/97, NË PRONËSI TË BASHKISË GRAMSH, PËR QËLLIME STREHIMI
DHE PRIVATIZIMI.

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës 31/07/2026, pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit dhe e Kontrollit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës, Sektori i Administrimit të Pronave Publike.

Bazuar në Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.12.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Gramsh, të qarkut të Elbasanit", dhe sipas VKM-së "Ish Ndërmarrja e Shqopave", ka kaluar në pronësi të Bashkisë Gramsh dhe është certifikuar.

Mbështetur në Ligjin nr. 22, datë 03.05.2018, "Për Strehimin Social" si dhe për vlerësimin e pronës referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 06.05.2026 i ndryshuar "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 179, datë 26.02.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave, që kanë qënë subjekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore", të ndryshuar.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2; neni 9 pika 1.2, me propozimin të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë

V E N D O S I:

1. Kthimin në fond banese të objektit "Ish Ndërmarrja e Shqopave", në pronësi të bashkisë Gramsh, ndarjen dhe certifikimin e çdo njësie banimi sipas listës së miratuar të banoreve që banojnë në to duke specifikuar dhe sipërfaqet respektive të tyre.

2. Nisjen e procedurave të privatizimit të familjareve që banojnë si më poshtë:

LISTA EMERORE E OBJEKTEVE TË DHËNA ME QIRA
OBJEKTI NR.1

PASURIA NR 7/97 ZK. 1842 ME SIPËRFAQE TOTALE S-376 M² DHE SIP. NDËRTESE S-KATI PËRDHE 207.6 M² + S- KATI PARË 176 M².
EMËRTIMI: ISH NDËRMARRJA E SHQOPAVE.

ME POSEDUES:

1.Valentina Dervishi me sip. 29.8m

- 2.Burbuqe Latifi me sip.44.6 m²
- 3.Besim Taragjini me sip.95 m²
- 4.Muke Tafa me sip. 89.4 m²
- 5.Nefail Tafa me sip. 82.2 m²
- 6.Xhile Velu me sip. 42.6 m²

3. Vlersimi i pronës të llogaritet sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 320, datë 06.05.2026 i ndryshuar.

4. Në përfundim të procedurës të lidhen kontratat e shitjes para noterit midis qytetarëve të mësipërm në cilësinë e blerësit dhe Bashkisë Gramsh në cilësinë e shitësit i përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij.

5.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Komisioni i Privatizimit të banesave pronë e bashkisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI

KRYETARI I KËSHILLIT

Enis ZANI

